



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Tiranë

VITI 2018

Tabela e Përmbajtjes

GJETJET KRYESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË TIRANË.....	4
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	6
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	10
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN ETYRE, PËRMES PROGRAMEVE TË SPECIALIZUARA.....	16
REKOMANDIME.....	17

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2018.

Gjetjet Kryesore

- Përgjatë vitit 2018 Gjykata e Tiranës, për çështjet civile ka regjistruar 198 raste për lëshim Urdhër Mbrojtje dhe 904 raste të Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Po kjo gjykatë në çështjet penale ka regjistruar 365 raste të dhunës në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4.
- Sipas të dhënave nga Drejtoria Vendore e Policisë, për Bashkinë Tiranë janë evidentuar 1344 raste të dhunës në familje, nga të cilat 377 raste sipas nenit 130/a, ku 158 agresorë janë arrestuar.
- Bashkia Tiranë, për vitin 2018 nëpërmjet Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në bashkëpunim me institucionet e linjës ka organizuar 12 fushata ndërgjegjësuese me pjesëmarrjen e 335 personave.
- Gjatë vitit 2018, Bashkia Tiranë ka bashkëpunuar në mënyrë të ngushtë me një numër organizatash fetare si Fondacioni “Firdeus” dhe Fondacioni “Mirënjohja”.
- Gjatë vitit 2018, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me institucionet dhe OJF-të pjesë të Mekanizmit të Referimit ka mbështetur 302 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga të cilat 148 raste raste janë përfaqësuar dhe në Gjykatë, ndërsa 115 raste kanë përfituar mbështetje psikologjike.
- Sistemi REVALB perdoret sistematikisht por problemet nuk mungojnë. Megjithëse koordinatori vendore pranë Bashkisë Tiranë është trajnuar për hedhjen e rasteve të dhunës në këtë sistem, shpesh ka hasur në probleme, sidomos, me ndarjen e re territoriale.
- Gjatë vitit 2018 janë organizuar 11 mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar.
- Bashkia Tiranë ka hasur problematika në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e kësaj kategorie.
- Bashkia Tiranë nuk ka një Strehëz emergjence (0-48 orë) për viktimat e dhunës në familje, synon mbështetjen e qendrave të specializuara për ofrimin e shërbimeve ri-integruese për trajtimin e rasteve viktimat të dhunës në familje si dhe të fëmijëve të tyre, përmes mbulimit të një pjese të kostove të shërbimeve.

- Pothuajse në të gjitha trajtimet e rasteve, çështja e strehimit, sidomos për periudhën 24-48 orë deri në lëshimin e UMM/UM është një prej problematikave kryesore të bashkisë Tiranë.
- Sfidë për këtë bashki mbetet edhe raportimi i dhunës në zonat rurale, pasi shumë raste dhune në zonat rurale nuk raportohen.
- Një tjetër vështirësi që haset për këtë kategori, është ajo e trajtimit afatgjatë të viktimave të dhunës përmes punësimit pasi në raste të shumta ato (viktimat) nuk zgjedhin të punojnë por preferojnë ndihmën ekonomike. Në këtë drejtim, Bashkia e Tiranës si institucioni koordinues i MR Tiranë, ka vendosur urat e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve të formimit profesional; duke i kushtuar vëmendje të veçantë projekteve të nxitjes së punësimit, me qëllim fuqizimin social ekonomik të grave dhe vajzave vulnerabël në përgjithësi dhe vajzave dhe grave që kanë pësuar dhunë në veçanti.
- Numri i grave të dhunuara të cilat kanë qenë dhe janë përfituese të bonusit të strehimit përgjatë viteve 2016-2018, është 13, ose është përdorur 4 % e buxhetit. Të gjitha rastet e dhunës e kanë përfituar bonusin në masën 100%.
- Njësoj si një vit më parë, në Bashkinë Tiranë nuk është organizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për vitin 2018.
- Bashkia ka rinovuar Marreveshjen e Bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit në Korrik 2018 duke e përfshirë dhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem në kuadër të dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara.
- Gjatë vitit 2018, 73 ishin klientët që u trajtuan nga Linja e Këshillimit për burra dhe djem. 62 prej tyre u referuan nga shërbimet shtetërore ose OJF-të e tjera bashkëpunuese dhe 11 klientë u vetëreferuan pranë këtij institucioni.
- Trajtimi i dhunuesve është një tjetër problematikë e rëndësishme që Bashkia e Tiranës ka hasur edhe përgjatë vitit 2018.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Tiranë

Sipas të dhënave të fundit të INSTAT publikuar në tetor 2018, dhuna ndaj grave në Qarkun Tiranë është 26.3 gra për 10 mijë banorë, duke mbajtur kështu vendin e tretë në rang vendi, pas Durrësit dhe Vlorës.

¹Përgjatë vitit 2018 Gjykata e Tiranës, për çështjet civile ka regjistruar 1608 çështje të reja, padi për zgjidhje martesë dhe 198 raste për lëshim Urdhër Mbrojtje. Në vijim, 904 ishin rastet e paraqitura në të njëjtën gjykatë në lidhje me lëshimin e Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes.

Po kjo gjykatë në çështjet penale ka regjistruar 365 raste të dhunës në familje sipas nenit 130/a/1,2,3,4. Specifikisht të ndara si vijon:

¹ ëëë.gjykatatirana.gov.al/evidencat

Neni 130/a/1 – 209 raste të reja
 Neni 130/a/2 – 17 raste të reja
 Neni 130/a/3 – 21 raste të reja
 Neni 130/a/4 – 118 raste të reja.

Drejtoria Vendore e Policisë Qarku Tiranë ka në përbërjen e saj 5 komisariate të cilat janë nën juridiksionin e Bashkisë Tiranë, specifikisht Komisariami nr. 1, nr.2, nr.3, nr.4 dhe nr.6. Të gjitha të dhënat mbledhen e më pas përpunohen në Drejtorinë vendore të Policisë së qarkut Tiranë.

Përgjatë vitit kalendarik 2018 pranë këtyre komisariateve janë evidentuar gjithsej 1344 raste të dhunës në familje, ku 377 raste sipas nenit 130/a, nga të cilat 158 agresorë janë arrestuar.

Sipas të dhënave nga Drejtoria Vendore e Policisë, për Bashkinë Tiranë, janë komisarimet nr.3 dhe 4 ato që mbajnë numrin më të lartë të rasteve të evidentuara të dhunës në familje. Bazuar në të dhënat e përfituara nga kjo drejtori vetëm 43 % e autorëve që kanë shkaktuar dhunë në familje janë arrestuar.

Ndërkohë po gjatë vitit kalendarik 2018, sipas Ligjit 9669, datë 18.12.2006, janë plotësuar 802 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje, shifër kjo më e lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, ku janë plotësuar 683 Kërkesë Padi për Urdhëra Mbrojtje.

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Bashkisë Tiranë

Dhuna në familje	Bashkia Durrës	Burra	Gra
Raste te evidentuara	1344		
Vrasje raste			
Viktima			
Kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje	802		
Shkelje Urdhër Mbrojtje	39		
Vepër penale- Neni 130/a	377		
Autorë të arrestuar	158		
Autorë të ndaluar	32		
Autorë të shpallur në kërkim			
Autorë në gjendje të lire			
Autorë të vetvuarë			

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

Sipas informacioneve zyrtare të përfituara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për bashkinë e Tiranës për periudhën 1 janar 2018 – 31 dhjetor 2018 janë regjistruar 273 procedime për dhunën në familje sipas nenit 130/a/1, nga të cilat janë proceduar 259 persona, janë pushuar 55 procedime, kanë kaluar në procedim gjyqësor 204 dhe 220 ishin personat e çuar në gjykatë për këtë çështje.

Informacionet e mëposhtme detajojnë të dhënat për secilin prej nën-neneve.

Tabela 2. Rastet e Dhunës në Familje në Prokurori

Neni	Mosfillime	Regjistruara procedime	Persona	Pushuar	Procedime Gjyqësore	Person në gjyq
130/a/1	123	273	259	55	204	220
130/a/2	1	20	17	5	16	16
130/a/3	-	25	25	2	28	28
130/a/4	1	114	115	12	115	115

Burimi: Prokuria e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Tiranë, për vitin 2018 nëpërmjet Sektorit të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, në bashkëpunim me institucionet e linjës kanë organizuar një sërë fushatash ndërgjegjësuese për promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe në familje. Fushatat ndërgjegjësuese janë trajtuar nga ky sektor në formatet më gjithëpërfshirëse dhe inovative, duke nxitur pjesëmarrjen masive të qytetarëve, të rinjve, sektorit privat, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sipas takime ndërgjegjësuese, u përfshinë në total 335 persona, 75 prej tyre morën edhe trajnime, me ndarjen si vijon:

- Në tre Universitete private të Tiranës ku kanë përfituar rreth 200 studentë; konkretisht në: Universitetin EPOKA; Universitetin BEDER dhe në Universitetin e NEW YORK-ut
- Takime me persona kyç të komunitetit (ku kanë përfituar rreth 60 punonjës të njësive administrative, staf të qendrave shëndetësore dhe shkollave/kopshteve të zonës etj) në Njësitë Administrative Krrabë; Shëngjergj dhe Bërzhitë.
- Takime me stafin e 24 Njësive Administrative, ku kanë përfituar rreth 75 punonjës të Njësive Administrative (PMF, administrator shoqërorë dhe specialistë të NE) ku u organizuan 6 trajnime

Në vijim, përgjatë vitit 2018 bëri prezantimin e punës së Mekanizmit të Referimit të Bashkisë Tiranë në:

- Webinarin për “Ndarje eksperiencash me Korenë e Jugut rreth Sistemit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës me bazë gjinore”
- Vizitën Studimore në Seul për shkëmbim eksperience për përvojat në fushën e trajtimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës seksuale.
- Takimin me gra dhe vajza nga Komuniteti PAK.

²Totali i buxhetit të bashkisë Tiranë për vitin 2018 ishte **1,260,364,314** Lekë, i cili sipas zërave është i ndarë në:

- Linjën e Këshillimit për Gra dhe Vajza: **474,000** Lekë
- Pagesa e Ndhmës Ekonomike për rastet që janë pajisur me urdhër mbrojtje: **2,253,000** Lekë.
- Paga e Koordinatorit Vendor për Dhunën në Familje: **57,870** Lekë.
- Projekti “*Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipermarrjes*”(Ku pjesë përfituese ndër të tjerë janë dhe te mbijetuarat/it e dhunës në familje): **11,000,000** Leke
- Bonusi i Strehimit (Ku pjesë përfituese ndër të tjerë janë dhe te mbijetuarat/it e dhunës në familje): **43,000,000** Lekë

Për organizimin e aktiviteteve për vitin 2018, bashkia Tiranë ka bashkëpunuar me:

1. Strehëza për Gra dhe Vajza
2. QDNJD
3. QZHK Sot për të Ardhmen
4. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
5. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Në korrik të vitit 2018, Bashkia e Tiranës nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi të mekanizmit të bashkërendimit të punës për referimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij. Marrëveshja u lidh ndërmjet institucioneve si vijon:

- Bashkia e Tiranës me përfaqësues z. Erion Veliaj, Kryetar;
- Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë me përfaqësues z. Kastriot Skënderaj, Drejtor;
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me përfaqësues z. Dritan Rreshka, Prokuror;
- Zyra Përmbartimore Tiranë me përfaqësues z. Enea Dyrmishi, Kryetar;
- Instituti i Mjekësisë Ligjore me përfaqësues z. Bledar Xhemali, Drejtor;
- Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë me përfaqësues z. Dritan Ulqinaku, Drejtor;
- QSUT “Nënë Tereza” me përfaqësues z. Enkelejdi Joti, Drejtor;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë me përfaqësuese znj. Manjola Kaçi, Drejtore;
- Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë me përfaqësuese znj. Arjola Byzyka, Drejtore;
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë me përfaqësuese znj. Julinda Gjonja, Drejtore;
- Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza dhe Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem me përfaqësuese znj. Iris Luarasi, Drejtore;
- Strehëza për Gra dhe Vajzaa Tiranë me përfaqësuese znj. Edlira Haxhiymeri, Drejtore Ekzekutive;
- Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të ardhmen” me përfaqësuese znj. Fabiola Laço Egro, Drejtore Ekzekutive;

² Burimi: Sektori I Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjimore

- Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, Tiranë me përfaqësuese znj, Afërdita Prroni, Drejtore.

Kjo marrëveshje ka si objekt koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve autoritare përgjegjëse në territorin e Bashkisë Tiranë për trajtimin e çështjeve të dhunës në familje, me anë të mekanizmit referues. Qëllimi i saj është përmirësimi i vazhdueshëm i nivelit të sigurisë së anëtarëve të komunitetit dhe sigurimi i mirëqënies për kategoritë e personave që janë viktime të dhunës në familje përmes sistemit të reagimit të koordinuar.

Stafi i Bashkisë Tiranë në datat 22 – 27 Prill 2018 mori pjesë në një vizitë studimore në Seul, me kuadër shërbimet për viktimat e dhunës në familje. Ky trajnim u bë i mundur nga mbështetja e UNDP Albania.

Megjithëse mekanizmi i referimit pranë Bashkisë Tiranë ka në mënyrë të vazhdueshme mbledhje apo dhe fokus grupe të përbashkëta, nuk kanë patur një trajnim të përbashkët në lidhje me dhunën në familje.

Në vijim, Bashkia Tiranë ka një bashkëpunim shumë të mirë prej vitesh me UNDP dhe UNWOMEN, bashkëpunim ky që vijon.

Tabela 3. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizua nga:
1	7.3.2018	Universiteti EPOKA	Njohja me Mekanizmin e Referimit dhe shërbimet për rastet e dhunës	Bashkia Tiranë
2	17.5.2018	Universiteti BEDER	Njohja me Mekanizmin e Referimit dhe shërbimet për rastet e dhunës	Bashkia Tiranë
3	24.5.2018	Universiteti i NEW YORK-ut	Njohja me Mekanizmin e Referimit dhe shërbimet për rastet e dhunës	Bashkia Tiranë
4	11.9.2018	Njësia Administrative KRRABË	Takim rreth dhunës në familje me persona kyç të komunitetit, punonjës të njësive administrative, staf të qendrave shëndetësore dhe shkollave/kopshteve të zonës etj	Bashkia Tiranë & Strehëza për Gra dhe Vajza
5	14.9.2018	Njësia Administrative Shëngjergj	Takim rreth dhunës në familje me persona kyç të komunitetit, punonjës të njësive administrative, staf të qendrave shëndetësore dhe shkollave/kopshteve të zonës etj	Bashkia Tiranë & Strehëza për Gra dhe Vajza
6	24.9.2018	Njësia Administrative	Takim rreth dhunës në familje me	Bashkia Tiranë &

		Bërzhite	persona kyç të komunitetit, punonjës të njësive administrative, staf të qendrave shëndetësore dhe shkollave/kopshteve të zonës etj	Strehëza për Gra dhe Vajza
7	4.10.2018	Ambjentet e Njesisë Administrative DAJT	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative nr. 4, Dajt, Shengjergj, Zall Bastar	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
8	15.10.2018	Qendra Sociale Multidisiplinare	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative nr. 1, 2, Farkë, Zall-Herr	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
9	16.10.2018	Qendra Sociale Multidisiplinare	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative nr. 3, 7, 8 dhe 11	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
10	17.10.2018	Qendra Sociale Multidisiplinare	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative nr. 5, 6, 9 dhe 10.	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
11	26.10.2018	Ambjentet e Njesisë Administrative BËRZHITË	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative Krrabë, Baldushk, Petrelë dhe Bërzhitë	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”

12	12.11.2018	Ambjentet e Njesisë Administrative VAQARR	Trajnim për ndryshimet e reja ligjore me administratorët shoqërorë, PMF-të dhe specialistët e NE të Njësive Administrative Kashar, Vaqarr, Pezë dhe Ndroq	Bashkia Tiranë dhe Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci”
----	------------	---	---	---

Gjatë vitit 2018, Bashkia Tiranë ka bashkëpunuar në mënyrë të ngushtë me një numër organizatash fetare si Fondacioni “Firdeus” dhe Fondacioni “Mirënjohja”, me të cilat ka nëshkruar marrëveshje bashkëpunimi 2 vjeçare. Me anë të këtyre bashkëpunimeve të vendosura janë ndihmuar shumë familje në nevojë duke përfshirë dhe raste të dhunës në familje, me paketa të ndryshme ushqimore, pagesë qiraje e të tjera të ngjashme.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Tiranë, në zbatim të Ligjit nr.9669, datë 18.12.2006 “Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare”, i ndryshuar, VKM-së nr. 334, datë 17.02.2011 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të Tij”, ka ngritur Mekanizmin e Referimit në Tiranë në maj 2012.

Gjithashtu në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2016-2020, Bashkia Tiranë ka përgjegjësi të drejtpërdrejta në këtë plan veprimi, kryesisht në qëllimet 3 & 4:

Qëllimi Strategjik 3: *Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje*

Qëllimi Strategjik 4: *Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore*

Spektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore menaxhon dhe ndihmon rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore duke siguruar mbrojtje, informim, strehim, këshillim psikologjik dhe ligjor dhe koordinim me të gjithë aktorët e rrejtit, këto në interes të viktimës.

Ky Mekanizëm reagon menjëherë dhe me përgjegjësinë e duhur me shërbimet e mëposhtme të cilat janë falas për të mbijetuarat e dhunës në familje:

1. Mbështetje multidisiplinare për të mbijetuarat/it e dhunës në marrëdhëniet familjare;
2. Strehim social (bonus qiraje, mbulim qiraje 2-3 muaj nga organizata bashkëpunëtores);
3. Këshillim psikologjik dhe ligjor;

4. Mbështetje të rasteve të dhunës në familje pranë institucioneve përkatëse: Gjykatë, Polici; Përmbarrim, Prokurori etj;
5. Aktivitete ndërgjegjësuese dhe informuese të komunitetit;
6. Linjën Kombëtare të Këshillimit 24 orëshe 116 dhe 117 pritëse, këshilluese dhe referuese të rasteve të dhunës në familje;
7. Këshillim për djem dhe burra përmes Linjës së Këshillimit për Djem dhe Burra;
8. Paketa të ndryshme ushqimore, veshmbathje, higjieno-sanitare etj

Gjatë vitit 2018, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me institucionet dhe OJF-të pjesë të Mekanizmit të Referimit ka mbështetur 302 raste të dhunës në marrëdhëniet familjare, nga të cilat 148 raste janë përfaqësuar dhe në Gjykatë, ndërsa 115 raste kanë përfituar mbështetje psikologjike.

Gjatë vitit 2018 janë organizuar 11 mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar. Këto janë edhe raportet që ndan koordinatori me anëtarët e MKR-së, duke dërguar njoftim zyrtar me anë të e-mailit para çdo mbledhje, si dhe minutat e takimit apo informacione shtesë sipas rastit pas çdo mbledhje.

Sistemi REVALB përdoret sistematikisht por problemet nuk mungojnë. Megjithatë koordinatori vendore pranë Bashkisë Tiranë është trajnuar për hedhjen e rasteve të dhunës në këtë sistem, shpesh ka hasur në probleme, sidomos, me ndarjen e re territoriale. Bashkia Tiranë ka tashmë 24 njësi administrative në varësi. Hedhja në sistem e numrit të madh të rasteve të dhunës për Tiranën nuk mund të bëhet në kohë reale vetëm nga një person sepse tanimë njësi vendore është shumë më e gjerë dhe patjetër duhet të ketë një lidhje shumë të ngushtë me administratorët shoqërorë, që janë në ndarjet më të vogla.

Përsa më sipër, koordinatori vendore kundër dhunës e sheh të arsyeshme trajnimin e pikave të tjera të kontaktit nga njësitë administrative që raportojnë më shumë raste dhune. Specifikisht këtu veçohen Njësitë Administrative nr. 4 & 6, të cilat kanë edhe numrin më të lartë të rasteve të dhunës në familje.

Nevojat e viktimave të dhunës në familje janë të shumta. Me kalimin e viteve janë shtuar edhe shërbimet e ofruara ndaj kësaj kategorie. Megjithatë arritjet e MR dhe reagimit të koordinuar të tij, ka ende problematika dhe sfida për trajtimin me sukses të rasteve të dhunës në familje.

Në këtë kuadër Bashkia e Tiranës ka nxjerrë në pah disa pika të cilat janë problematika të mëdha për ecurinë dhe zgjidhjen e këtyre rasteve. Pothuajse në të gjitha trajtimet e rasteve, çështja e strehimit, sidomos për periudhën 24- 48 orë deri në lëshimin e UMM/UM është një prej problematikave kryesore. Por strehimi mbetet problem edhe kur rasti kërkon zgjidhje afatgjatë. “Strehëza për Gratë dhe Vajzat” është një ndër aktorët kyç sa i takon Mekanizmit të Referimit, pasi mbulon nevojat bazë për strehim të rasteve emergjente që janë në dhunë ekstreme. Megjithatë, ndonëse ka këtë funksion, jo çdo rast që shpreh nevojën për strehim mund të strehohet në Strehëz. Ka kritere dhe procedura specifike që aplikohen për çdo rast prandaj, jo

gjithmonë ofrohet mundësia e strehimit (*si për shkak të mos plotësimit të këtyre kritereve, ashtu edhe për shkak të kapacitetit/infrastrukturës së limituar që ka kjo Strehëz*). Rekomandohet që për Bashkinë Tiranë të ketë një qendër të sajën strehimi, pasi dhe popullsia e kësaj bashkie është rreth 800 mijë banorë dhe rastet e dhunës janë evidente dhe kërkojnë zgjidhje.

Pavarësisht se, Bashkia Tiranë nuk ka një Strehëz emergjence (0-48 orë) për viktimat e dhunës në familje, synon mbështetjen e qendrave të specializuara për ofrimin e shërbimeve riintegruese për trajtimin e rasteve - viktimat të dhunës në familje si dhe të fëmijëve të tyre, përmes mbulimit të një pjese të kostove të shërbimeve. Gjithashtu, në bazë të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004, “*Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane*”, i ndryshuar; udhëzimit nr. 23, datë 30.12.2008 “*Për Përmbajtjen e Bonusit të Strehimit*”, Bashkia Tiranë, u jep përparësi kërkesave për strehim social të viktimave të dhunës në familje dhe personave me të ardhura nën minimumin jetik ku përfshihen dhe gratë.

Bashkia Tiranë shpesh ka hasur problematika në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e kësaj kategorie.

Gjithashtu sfidë për këtë bashki mbetet edhe raportimi i dhunës në zonat rurale, pasi shumë raste dhune në zonat rurale nuk raportohen. Për ta adresuar këtë problematikë, Bashkia Tiranë në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Mekanizmit ka organizuar takime ndërgjegjësuese të vazhdueshme me komunitetin e 13 njësive të reja administrative, duke qenë se me zgjerimin e Bashkisë së Tiranës pjesë funksionale e saj u bënë edhe ish komunat. Gjithashtu për këtë çështje, kjo bashki ka trajnuar dhe administratorët shoqërorë apo dhe punonjësit e NJMF.

Sipas Bashkisë Tiranë, një tjetër vështirësi që haset për këtë kategori, është ajo e trajtimit afatgjatë të viktimave të dhunës përmes punësimit pasi në raste të shumta ato nuk duan të punojnë por preferojnë ndihmë ekonomike. Në këtë drejtim, Bashkia e Tiranës si institucioni koordinues i MR Tiranë, ka vendosur urat e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimeve të formimit profesional; duke i kushtuar vëmendje të veçantë projekteve të nxitjes së punësimit, me qëllim fuqizimin social ekonomik të grave dhe vajzave vulnerabël në përgjithësi dhe vajzave dhe grave që kanë pësuar dhunë në veçanti.

Përveç pagës së Koordinatorës Vendore, Mekanizmit i Referimit dhe trajtimit të rasteve të DHBGJ&DHF po fuqizohet përmes buxhetimit nga Bashkia Tiranë të shërbimeve të specializuara, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe Konventës së Stambollit. Konkretisht Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza pjesë e MR Tirane është mbështetur gjatë vitit 2018 me shumën totale 474,000 lekë dhe do të vijojë të mbështetet gjatë 2019.

Numri i grave të dhunuara të cilat kanë qenë dhe janë përfituese të bonusit të strehimit përgjatë viteve 2016-2018, është 13, ose është përdorur 4 % e buxhetit. Të gjitha rastet e dhunës e kanë përfituar bonusin në masën 100%.

Koordinatorja është anëtare e rrjetit të bashkive të nëpunësve vendorë gjinorë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ajo mban marrëdhënie të pandërprera me Përgjegjësin e Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore në Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Koordinaore në Bashkinë e Tiranës është znj. Anjeza Bojaxhi e cila e mban këtë detyrë që prej vitit 2013. Znj.Bojaxhi kryen vetëm detyrat që i dikton ky pozicion pune dhe duke qenë se gëzon statusin e nëpunësit civil nuk ka një kontratë me bashkinë.

Trajnimi më i fundit që koordinatorja vendore pranë kësaj bashkie ka marrë është vizita studimore në Seul, me kuadër shërbimet për viktimat e dhunës në familje, trajnim ky i cili u mundësua nga UNDP Albania.

Paga e Koordinatorës Vendore është përfshirë në buxhetin e Bashkise Tirane që në shkurt 2013.

Në Bashkinë Tiranë, inspektore për barazinë gjinore dhe dhunën në familje është vetë shefja e këtij sektori znj. Aida Shehu. Por, përveç barazisë gjinore znj. Shehu mbulon edhe çështje të tjera të përfshirjes sociale si Komuniteti Rom dhe ai Egjiptian.

Bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë me Policinë ka qenë gjithmonë shumë i mirë që në fillimet e Mekanizmit të Referimit në Tiranë në 2012. Policia mbetet anetar kyç i Mekanizmit të Referimit Tiranë. Megjithë përdorimin e shkresave të ndryshme kryesisht me anë të postës elektronike, rastet e dhunës në familje menaxhohen përmes bashkëpunimit tepër të ngushtë të Koordinatorës Vendore me specialistet e Policisë pjesë të GTNsë.

Ndërkohë që bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë me Zyrën Rajonale të Punës ka ardhur në rritje krahasuar me vitin që lamë pas. Bashkia Tiranë ka referuar vazhdimisht raste të dhunës pranë Zyrës së Punës. Megjithatë problem mbetet trajtimi afatgjatë i viktimave të dhunës përmes punësimit pasi në raste të shumta ato nuk preferojnë të punojnë por parapëlqejnë ndihmën ekonomike. Kryesisht bashkëpunimi mes këtyre institucioneve kryhet nëpërmjet postës elektronike pasi rastet e dhunës në familje menaxhohen përmes bashkëpunimit dhe komunikimit të vazhdueshëm të Koordinatorës Vendore me përfaqesuesen e Zyrës së Punës prezente në mbledhjet e GTNsë.

Për vitin 2018 bashkëpunimi i Bashkisë Tiranë me DAR Tiranë ka qenë i kënaqshëm. Prej vitesh kjo drejtori ka dhënë një ndihmesë shumë të madhe në organizimin e aktiviteteve ndërjegjësuere në të gjitha shkollat e mesme të Tiranës. Edhe bashkëpunimi me Zyrën Rajonale të Shërbimit Social paraqitet i kënaqshëm nga Bashkia Tiranë. Bashkëpunimi menaxhohet përmes komunikimit të vazhdueshëm të Koordinatorës Vendore me përfaqësuesen e Zyrës Rajonale Tiranë të ShS.

Tabela 4. Numri i mbledhjeve të GTN-së ne vitin 2018 në Bashkinë Tiranë

Data	Vendi	Temat
25.1.2018	Bashkia Tiranë	Çështjet gjinore: Dhuna në familje dhe martesat e hershme"
8.2.2018	Bashkia Tiranë	Diskutimi i rasteve në menaxhim si dhe hedhja e ideve për organizmin e aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të 8 Marsit.
21.2.2018	Bashkia Tiranë	Diskutime rreth draft-Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore
23.3.2018	Bashkia Tiranë	Diskutimi i rasteve në menaxhim si dhe prezantimi i gjetjeve nga vlerësimi i kryer në kuadër të studimit të ndërmarrë nga UN Women në bashkëpunim me Policinë e Shtetit Shqiptar, Programin Ndërkombëtar të Trajnimit dhe Asistencës për Investigimin e Krimeve (ICITAP), UNDP dhe Ambasadën Hollandeze, si dhe me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
9.5.2018	Bashkia Tiranë	Diskutimi i disa rasteve të dhunës në menaxhim dhe njoftimi i anëtarëve të Mekanizmit për rishikimin e detyrave të tyre në Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit me që është në rinovimin e siper.
26.6.2018	Bashkia Tiranë	Diskutimi i disa rasteve delikate të dhunës në familje.
12.9.2018	Bashkia Tiranë	Dorëzimi i kopjeve të nënshkruara të Marrëveshjes së rinovuar të Bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit.
10.10.2018	Bashkia Tiranë	Prezantimi i raportit mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri.
6 .11.2018	Bashkia Tiranë	GTN urgjente për menaxhimin e një rasti tepër delikat të dhunës në familje nga bashkeshorti ndaj ish-bashkëshortes dhe 4 fëmijëve.
20.11.2018	Bashkia Tiranë	Kalendari i aktiviteteve të përbashkëta në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër Dhunës me bazë gjinore.
21.12.2018	Bashkia Tiranë	Raportim për rastet e trajtuara nga anëtarët e Mekanizmit gjatë 2018-ës si dhe informacion për qendrën e parë për trajtimin e viktimave të dhunës seksuale nga përfaqësuesja e MSHMS.

Në të gjitha mbledhjet e GTN pjesmarrja ka qenë e plotë nga institucionet si vijon:

1. Drejtorja e Policisë së Qarkut Tiranë,
2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë,
3. Prokuroria e Rrethit Tiranë,
4. Zyra e Përmbartimit Tiranë,
5. Instituti i Mjekësisë Ligjore Tiranë,
6. Autoriteti Shëndetësor Rajonal Tiranë,
7. Spitali (QSUT) Tiranë,
8. Drejtorja e Shërbimit Social Shtetëror Tiranë,
9. Drejtorja Arsimore Rajonale Tiranë,
10. Zyra Rajonale e Punësimit Tiranë,
11. Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë,
12. Qendra për Zhvillim Komunitar “Sot për të Ardhmen”.

13. Qendra “Të Drejtat e Njeriut në Demokraci” (është përfshirë në Mekanizmin e Referimit gjatë vitit 2017 përmes një Marrëveshje Bashkëpunimi)
14. Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza
15. Linja e Këshillimit për Burra dhe Djem

Ndërkohë, po njësoj si një vit më parë, në Bashkinë Tiranë nuk është organizuar asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues për vitin 2018.

Tabela 5. Këshlli Drejtues bashkia Tiranë

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Erjon Veliaj, Kryetar
Drejtoria e Policisë	Kastriot Skenderaj, Lindita Lushaku, Elena Hasango
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Enkelejd Hajro, Alba Nikolla
Prokuroria e Rrethit	Dritan Rreshka
Drejtoria Arsimore Rajonale	Ajola Byzyka, Edlir Tërpo
Drejtoria e Shëndetit Publik	Dritan Ulqinaku, Rudina Basha
Zyra e Përmbarimit	Enea Dyrmishi, Dorina Saja

Tabela 6. GTN-ja e Bashkisë Tiranë viti 2018

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2018
Bashkia	Anjeza Bojaxhiu
Drejtoria e Policisë	Elena Hasango
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Alba Nikolla
Prokuroria e Rrethit	Dritan Rreshka
Drejtoria Arsimore Rajonale	Edlir Tërpo
Drejtoria e Shëndetit Publik	Rudina Basha
Zyra e Përmbarimit	Dorina Saja
Prefektura	Nuk ka
Kryetarët e Njësive Administrative	Nuk ka
Zyra e Punësimit	Vera Mborja
Organizata Jo qeveritare	Migena Ismailati
Strehëzat për viktimat e dhunës	Marsela Allmuça
Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk ka

Burimi: Bashkia Tiranë

Në Bashkinë e Tiranës janë Specialistet e policisë së zonës në komisaritet përkatëse ata që plotësojnë UM dhe UMM-es. Në pjesën më të madhe të rasteve punonjësi përgjegjës i Njesisë Administrative është prezent në komisariat dhe bashkërendon punën me specialistin e policisë së zonës. Ndërkohë që gjatë këtij viti nuk është plotësuar asnjë i tillë nga Bashkia Tiranë.

Bashkia Tiranë përmes punonjësve të trajnuar për çështjet e dhunës në çdo Njësi Administrative vazhdimisht referon raste të dhunës tek Strehëza Kombëtare. Si rrjedhojë gjatë vitit 2018 janë referuar më shumë raste seç ka patur kapacitet Strehëza pasi problem kryesor për bashkinë gjatë trajtimit të rasteve të dhunës, siç është përmendur edhe më sipër, mbetet gjithmonë çështja e strehimit, sidomos për periudhën 24-48 orë deri në lëshimin e UMM/UM. Por strehimi mbetet problem edhe kur rasti kërkon zgjidhje afatgjatë. Jo çdo rast që shpreh nevojën për strehim mund të strehohet në Strehëz. Ka kritere dhe procedura specifike që aplikohen për çdo rast prandaj dhe jo gjithmonë ofrohet mundësia e strehimit, si për shkak të mos plotësimit të këtyre kritereve, ashtu edhe për shkak të kapacitetit/infrastrukturës së limituar që ofron kjo Strehëz.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi i dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin etyre, përmes programeve të specializuara.

Sipas informacioneve të publikuara në faqen zyrtare të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kjo gjykatë pëtgjatë vitit 2018 ka pranuar lëshimin e 69 UM dhe 310 UMM.

Sipas drejtuesve të Shërbimit të Provës, për vitin 2018 pranë zyrës vendore Tiranë kanë hyrë 165 urdhra ekzekutimi për të mbikqyruar të dënuar për veprën penale dhunë në familje.

Bashkia ka rinovuar Marreveshjen e Bashkëpunimit për Mekanizmin e Referimit në Korrik 2018 duke e përfshirë dhe Linjën e Këshillimit për Burra dhe Djem në kuadër të dhënies së mundësisë për rehabilitimin e dhunuesve përmes programeve të specializuara.

Gjatë vitit 2018, 73 ishin klientët që u trajtuan nga Linja e Këshillimit për burra dhe djem. 62 prej tyre u referuan nga shërbimet shtetërore ose OJF-të e tjera bashkëpunuese dhe 11 klientë u vetëreferuan pranë këtij institucioni. Specifikisht, u referuan 44 raste nga Drejtoria e Burgjeve, 17 raste kishin si referim Shërbimin e Provës dhe 1 rast u referua nga Nisma Ligjore.

Përsa më sipër, LKBD ofroi dhe kreu 585 seanca, mesatarisht 8 seanca për klient. Ndërkohë që kategorizimi i tyre sipas moshës tregon se 14 % e rasteve ishin të grupmoshës 18 – 25 vjeç; grupmosha 26 – 35 vjeç zinte 22 % të rasteve të referuara, 40 % e tyre ishin të grupmoshës 36 – 45 vjeç; 19 % e rasteve zinin grupmoshën 46 – 55 vjeç dhe 5 % të rasteve ishin të grupmoshës 56 – 67 vjeç. Në total, 72 % e klientëve të kësaj linje kishin ushtruar dhunë fizike ndaj partneres dhe 23 % e tyre kishin ushtruar dhunë psikologjike.

Trajtimi i dhunuesve është një tjetër problematikë e rëndësishme që Bashkia e Tiranës ka hasur edhe përgjatë vitit 2018. Ndërkohë që e mbijetuara e dhunës dhe fëmijët përfitojnë nga shërbime multidisciplinare; (fëmijët, pasi mbaron vendimi i gjykatës për urdhrin e mbrojtjes do ta takojnë sërish babanë dhunues). Prandaj, pjesa e integritit, e trajtimit dhe rehabilitimit të dhunuesve është bërë nevojë e domosdoshme. Duke qenë se punohet për familjen e shëndetshme dhe fuqizimin e saj, në momentin që kjo familje nuk është më e shëndetshme, atëherë përprjekjet

duhet të bëhen për rehabilitimin e të gjithë familjes, jo vetëm për gruan dhe fëmijët por edhe dhunuesit.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Tiranës për vitin 2018, më poshtë renditen disa rekomandime të cilat kërkojnë masa të menjëherëshme për të rregulluar funksionimin e Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Tiranë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ, kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje:

- Rekomandohet rishikimi i modulit të Sistemi REVALB, megjithëse koordinatoresha vendore pranë Bashkisë Tiranë është trajnuar për hedhjen e rasteve të dhunës në këtë sistem, shpesh hasen problematika, sidomos, me ndarjen e re territoriale. Problematikë kjo e ngritur edhe nga bashkitë e tjera pjesë e monitorimit.
- Me ndarjen e re territoriale, rekomandohet gjithashtu trajnimi për sistemin REVALB, i pikave të tjera të kontaktit nga njësitë administrative që raportojnë më shumë raste dhune. Specifikisht këtu veçohen Njësitë Administrative nr. 4 & 6, të cilat kanë edhe numrin më të lartë të rasteve të dhunës në familje
- Bashkia Tiranë ka hasur problematika në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e kësaj kategorie. Ndaj rekomandohet që kjo çështje të diskutohet dhe të gjendet një zgjidhje sa më e shpejtë.
- Në bashkinë e Tiranës mungon një strehëz emergjence (0 – 48 orë) e cila do të lehtësonte adresimin e rasteve të referuara që kanë nevojë për vëmendje të menjëhershme nga ana e mekanizmit të referimit.
- Sfidë për këtë bashki mbetet edhe raportimi i dhunës në zonat rurale, pasi shumë raste dhune në zonat rurale nuk raportohen, ndaj është e nevojshme ndërhyrja edhe më e madhe me fushata informuese dhe ndërgjegjësuere për këto zona.
- Bazuar në numrin shumë të lartë të raportimeve në bashkinë Tiranë për vitin 2018, kërkohet bashkëpunim dhe ndërveprim me të gjithë aktorët e GTN-së. Trajnimi i tyre dhe qendrueshmëria e stafit përfaqësues të institucioneve në GTN është domosdoshmëri
- Çdo insitucion duhet të marrë pjesë në mbledhjet e GTN-së dhe të marrë përgjegjësi jo thjesht të marrë pjesë.
- Duhet lehtësuar procesi i raportimit të Urdhërave të Mbrojtjes dhe Urdhërave të Menjëhershëm të Mbrojtjes nga ana e Gjykatës pasi procesi aktual e shmang bashkinë e cila i merr me shumë vonesë të dhënat.
- Sikurse edhe për bashki të tjera të monitoruara paraqitet nevoja e adresimit të mundësive rehabilituese për dhunuesit dhe rritjen e rolit të bashkisë dhe institucioneve të tjera pjesëmarrëse në mekanizmin e referimit për ofrimin e këtij shërbimi.
- Bashkia e Tiranës duhet të alokojë buxhet të mjaftueshëm për aktivitete dhe material ndërgjegjësuere kundër dhunës në familje.

- Bashkia e Tiranës duhet të ofrojë shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe për personat e dënuar për dhunë me bazë gjinore.
- MKR-ja Tiranë duhet të veprojë si një e tërë për të gjitha rastet e dhunës me bazë gjinore. Roli i çdo institucioni është shumë i rëndësishëm që rasti të marrë të gjithë ndihmën e duhur si viktimat, fëmijët por edhe dhunuesit.
- NBGj duhet të organizojë takime dhe të informojë të gjithë anëtarët e MKR-së në rastet kur ata ndërrohen për shkak të detyrës apo ndonjë arsyeje tjetër.
- Gjatë mbledhjeve duke qenë se mbahen minutat dhe të përgatiten skedat e të dhënave për rastet konkrete, ato (rastet) të ndiqen deri në krijimin e bindjes se janë jashtë rrezikut të dhunuesit.
- Punësimi i grave të dhunuara mbetet një tjetër problematikë e kësaj bashkie. Megjithë vendosjen e urave lidhëse me aktorët e tjerë, pjesë të mekanizmit, punësimi i këtyre grave mbetet në shifra shumë të ulëta, ndaj rekomandohet që të punohet sa më shumë për formimin profesional.